



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 14.08.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës datës 13.08.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik ALBI COMPANY SHPK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i stadiumit në Novosellë”, Nr. i prokurimit- 632-26-5931-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-042-511, nxjerr:

V E N D I M

- 1. REFUZOHET SI E PABAZUAR** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik ALBI COMPANY SHPK e dt.13.08.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i stadiumit në Novosellë”, Nr. i prokurimit- 632-26-5931-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-042-511, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 12.08.2026 të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. VËRTETOHET** DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, TË PUBLIKUAR ME DATË: 12.08.2026;
- 3.** Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
- 4.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori ekonomik ALBI COMPANY SHPK e dt.13.08.2026, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i stadiumit në Novosellë “, Nr. i prokurimit- 632-26-5931-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-042-511.

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, më datë 14.08.2026, gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, ka konstatuar se:

- **Pretendimi i parë** sa i përket pajisjes (Nr.3) *Pajisje për evidentimin e instalimeve elektrike*, kjo kërkesë vlerësohet si e pabazuar;
- **Pretendimi i dytë** sa i përket pajisjes (Nr.7) *Gjysëmrimokio kompresor ajri (duhet të këtë certifikatë të regjistrimit të automjetit i cili ka afat valid regjistrimit)*, kjo kërkesë vlerësohet si e pabazuar;
- **Pretendimi i tretë** sa i përket pajisjes (Nr.8) *Pajisje për largimin e lagështisë*, kjo kërkesë vlerësohet si e pabazuar;
- **Pretendimi i katërt** sa i përket pajisjes (Nr.9) *Ndriçues me gjenerator me katër (4) llapma me peshe 1-3t*, kjo kërkesë vlerësohet si e pabazuar ;
- **Pretendimi i pestë** sa i përket pajisjes (Nr.10) *Hillt demolues me derivate*, kjo kërkesë vlerësohet si e pabazuar;
- **Pretendimi i gjashtë** sa i përket pajisjes (Nr.11) *Mini ekskavator me peshë totale deri ne 2t*, kjo kërkesë vlerësohet si e pabazuar;
- **Pretendimi i shtatë** sa i përket pajisjes (Nr.13) *Kontinier montues në kamion me peshë totale deri ne 2 t*, kjo kërkesë vlerësohet si e pa pabazuar.

Andaj, pas konsultimeve me Zyrën e Projekteve, Autoriteti Kontraktues vlerëson se pajisjet në listën e publikuar janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës. Kështu që duke marrë parasysh natyrën e punimeve dhe kërkesat teknike të përcaktuara për realizimin e kontratës, pretendimet tuaja refuzohet si i pabazuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kopje:

Operatorit Ekonomik;

Zyrës së Kryetarit të Komunës;

Të gjitha palëve të interesuara;

FATON GUTAJ

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e paknaqur brenda afatit prej 10 ditëve mund të paraqesë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP).